

Qendra "ASET" promovon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, drejtësinë dhe sigurinë sociale, paqen, zhvillimin territorial dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Synon të sigurojë dinjitet dhe barazi, garantimin e të drejtave të personave duke zhvilluar çdo formë të solidaritetit social ndërmjet individëve, duke luftuar çdo formë të varfërisë, duke promovuar iniciativa kulturore, edukative si dhe asistencë ligjore, sociale e shëndetësore.

Kjo broshurë është hartuar në kuadër të Projektit: "Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve" i zbatuar nga Qendra për Administrim Social Ekonomik Territorial – ASET.

Kjo ndërhyrje është pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja e Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terre des hommes në Shqipëri. "

Përmbajtja e këtij materiali jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Terre des hommes në Shqipëri.



www.asetcenter.al
+355 693113606
info@asetcenter.al



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Terre des hommes
Helping children worldwide. tdh.ch



Save the Children

"MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE"



QENDRA PËR ADMINISTRIM
SOCIAL EKONOMIK
TERRITORIAL

Hyrje

Kjo broshurë është hartuar në kuadër të Projektit:

“Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve” i zbatuar nga Qendra për Administrim Social Ekonomik Territorial – ASET. Projekti synoi pilotimin e metodës Kompasito për edukimin e fëmijëve dhe stafeve për Qendra për Fëmijët në Situata Rruge i cili shërbeu për rritjen dhe fuqizimin e angazhimit dhe aktivizimit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Metoda Kompasito – metodë ndërvepruese trajnimi për fëmijët dhe profesionistët e Qendrave për Fëmijët në Situata Rruge.

Kjo ndërhyrje është pjesë e skemës së granteve të projektit

fuqizojë fëmijët të angazhohen dhe aftësohen në organizimin e aktiviteteve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ky projekt shërbeu si një standart pilot për rritjen cilësore të shërbimeve sociale në ndihmë dhe respektim të të drejtave të fëmijëve në situata rruge duke pilotuar metodën Kompasito në realitetin shqiptar me qëllim përhapjen e saj në qendrat e tjera që kanë në fokus fëmijët.

Nevojat bazë për zbatimin e projektit

Nga analiza e raporteve të organizatës Unicef

“Përfshirja e Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terre des hommes në Shqipëri. ”

Përmes kësaj ndërhyrje është arritur rritja e ndërgjegjësimit të personelit dhe të fëmijëve në qendrat për fëmijë e adoleshentë në situata rruge, mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre. Instrumenti kryesor i këtij projekti është realizimi trajnimeve përmes metodës “Kompasito”, që po përhapet gjerësisht në Europë, si një metodë efektive për t’u informuar për mbrojtjen e të drejtave, pjesëmarrjen në vendimmarrje, me fokus fëmijët e këtyre qendrave, që janë më të rrezikuarit nga abuzimet dhe dhuna. Ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe rritja e dijeve të tyre mbi të drejtat dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje përmes trajnimit edhe të personelit përgjegjës, sipas metodës Kompasito, e bazuar tek mënyrat tërheqëse si lojërat, aktivitetet dhe diskutimet do t’i

www.unicef.org/Albania për përfshirjen sociale të fëmijëve në Shqipëri) është gjetur se, fëmijët në qendrat e përkujdesit social përballen me mungesën e formimit të tyre, mosaftësimin e tyre dhe mungesën e pavarësisë në rastet kur jetojnë në qendra apo institucione ku mundësitë për zhvillim dhe pavarësi janë më të pakta. Nga raportimi i Ministrisë Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në Tetor 2016, është bërë me dije se asnjë nga donatorët, apo nga strukturat shtetërore nuk ka planifikuar trajnime dhe ngritje kapacitetesh me fëmijët dhe për fëmijët, duke i patur ata në fokus dhe duke i përfshirë në trajnime cilësore për vetëaftësimin e tyre, apo aq më tepër për ndërveprim me personelin dhe e ofruar kjo nëpërmjet lojës. Aplikimi i metodës Kompasito është një kërkesë e domosdoshme në kuadër të integritetit të edukimit dhe ofrimit

të shërbimeve të përkujdesit social ndaj fëmijëve në Shqipëri sipas standardeve të Bashkimit Europian.

Duhet theksuar se nga studimet rezulton se problemet e rritjes së vetëkonsideratës dhe krijimit të karakterit e personalitetit për fëmijët që nuk jetojnë pranë familjeve janë më të mundshme sesa të fëmijëve që rriten pranë familjeve, dhe këto shtohen prej përballjes me fenomenin e bullizmit, apo të dhunës verbale brënda dhe jashtë qëndrave të përkujdesit, fenomen që ndodh rëndom.

Drejtueset e Qendrave për fëmijë në situatë rruge pranonin se qendrat ofrojnë aktivitete të parashikuara në disa ditë mujore ku janë planifikuar edhe diskutime për të drejtat e fëmijëve.

Sipas drejtueseve fëmijëve iu mungon inisiativa për t'u angazhuar, iu mungojnë modelet pozitive, dëshira për të ndihmuar dhe se, janë gjithnjë duke pritur çdo gjë nga të tjerët, qoftë edhe falas.

Edhe psikologët pohuan se ka një kalendar të paracaktuar lidhur me mbajtjen e aktiviteteve me fokus diskutimin e të drejtave të fëmijëve sipas Ditëve të të Drejtave. Përgjithsisht, diskutimi i të drejtave zhvillohej nga mësueset e Qendrave me grupet e vogla që ato kishin në kujdestari.

Lidhur me nevojat e domosdoshme mbi politikat për shëndetin mendor dhe mirëqënien e këtyre fëmijëve, psikologët u shprehën se është e domosdoshme dhe puna me prindërit e të gjithë fëmijëve dhe bashkëpunimi me ta për ti cuar fëmijët në shkollë dhe për ti edukuar.

Pyetjes nëse do të ishte e nevojshme që këta prindër të trajtoheshin në kurse të detyrueshme disa orëshe lidhur me nevojat,

të drejtat e fëmijëve dhe informacione në ndihmë të prindërimit më të mirë, psikologja u përgjigj se kjo do të ishte një nga mënyrat më të mira për t'i përgatitur këta prindër të jenë më të dobishëm për fëmijët e tyre por e shohin si një sfidë pasi jo gjithmonë arrihet bashkëpunimi me prindërit dhe angazhimi i tyre në Qendra është jo shumë i madh.

Aktivitete të realizuara

Nëpërmjet projektit u arrit realizimi i nevojave specifike për qendrat e identifikuar, që ndodhet në Tiranë dhe në Shkodër. Në këtë kontekst u realizua kryerja e një analizë të detajuar në lidhje me shërbimet e ofruara dhe me kapacitetet e stafit, njohjen e tyre me të drejtat dhe përgjegjësitë, të ndërsjella këto dhe me fokus te fëmijët. Katër qendrat të cilat u përfshinë në projekt janë:

- Qendra Sociale Multidisiplinare, Tiranë
- Qendra Shtëpia e Ngjyrave-ARIS, Tiranë
- Qendra Engjejt e Vegjel- SHKEJ, Tiranë
- Qendra Komunitare numër 4, Shkodër

Së pari, për secilën nga qendrat u realizua analiza e nevojave të ndërveprimit nëpërmjet metodave bashkohore dhe hartimi i një plani veprimi e zhvillimi i të gjithë nevojave.

Më pas pilotimi i metodës Kompasito u realizua në realitetin shqiptar për stafet, dhe për fëmijët, përmes trajnimeve interaktive që garantuan pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimarrje dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Informimi i fëmijëve, përfitues të këtyre shërbimeve në Qendrat për Fëmijët në Situata Rruge u arrit nëpërmjet trajnimeve joformale sociale për të njohur të

drejtat dhe përgjegjësitë duke ndërvepruar me edukatorët e personelin. Aplikimi prej tyre i dijeve të reja në Javën e Aktiviteteve origjinale të ideuara prej tyre, rezultoi shumë i sukseshëm.

Gjatë muajit të parë u hartuan marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Tiranë dhe u komunikua me drejtueset e Qendrave.

Gjithashtu u vlerësua dokumentacioni; u analizua dokumentacioni arkivor që kishin të katër qendrat dhe raportet ndër vite, që na u vunë në dispozicion elektronikisht, duke ruajtur konfidencialitetin tyre në përputhje me rregulloret.

Ndërkohë, për vlerësimin e njohurive që fëmijët kanë mbi të drejtat e tyre dhe zbatimin e këtyre të drejtave në Qendrat për Fëmijët në Situatë Rruge, si proces i parashikuar në projekt, u zgjodh si metodë e bazuar në metodologjinë Stock & Flow, intervistat me edukatorë, fëmijë, psikologët dhe drejtueset e tyre, si dhe vëzhgimi i dokumentacionit të qendrave i përshkruar si më sipër. Ekspertet u kujdesën që të anketuarit të ishin përfaqësues (kampion) të çdo grup interesi, për të pasur rezultate të sakta sipas metodës Stock&Flow. Për secilën prej qendrave u intervistuan 4 fëmijë.

Pyetjet e ngritura u ndërtuan për të mbledhur informacione mbi njohuritë e fëmijëve lidhur me të drejtat e tyre, ku i mësojnë ata të drejtat dhe cilët janë personat që ua mësojnë të drejtat. Këto pyetje iu shtruan edhe drejtuesve, edhe kujdestareve, psikologeve, dhe vetë fëmijëve. Pyetjet ishin gjysëm të hapura, për të lënë vend për pyetje shtesë, nëse gjatë intervistimit gjykohej e domosdoshme.

Gjithashtu, stafi i përzgjedhur u anketua edhe lidhur me besimet e tyre se sa diskriminimi, padrejtësitë ndikojnë në

shëndetin mendor, fizik dhe emocional të fëmijëve. Një pyetje tjetër e rëndësishme ishte besimi i stafit mbi cilësinë e komunikimit mes edukatorëve dhe fëmijëve apo edhe mes vetë fëmijëve (për këtë u pyetën drejtueset dhe fëmijët). Ndërkohë fëmijët u anketuan mbi përdorimin ose jo të formave të ndryshme të dhunës ndaj tyre, komunikimin mes njëri-tjetrit, etj. Të gjitha informacionet e mbledhura u përdorën për të hartuar hartën e nevojave kryesore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ndërveprimin mes tyre dhe personelit në 4

Qendrat për Fëmijët në Situatë Rruge në Shkodër dhe në Tiranë.

Për të identifikuar nevojat e fëmijëve për trajnim për të drejtat e fëmijëve në cdo Qendër janë përzgjedhur 4 fëmijë për t'u intervistuar në formën e një bisede miqësore duke trajtuar çështjet e lojërave dhe aktiviteteve që kryhen në qendër, çfarë i pëlqen më shumë, si përzgjedh ai lojërat me shokët apo bashkë me edukatorin/punonjësen sociale, apo psikologun? A i njeh ai të drejtat e tij, po përgjegjësitë e tij, duke marrë këtë informacion duke luajtur me të dhe duke biseduar. A ka dëshirë të bëjë lojëra me tullumbace dhe mjete të tjera didaktike për të mësuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tij?

Gjatë përzgjedhjes së fëmijëve kemi patur parasysh kriterin e moshës. Fëmijët janë marrë nga 3 grup moshë të ndryshme :

- 6-9 vjec
- 9-12 vjec
- 12-14 vjec

Metoda jonë e trajnimit Kompasito është e përshtatshme për fëmijë 6 deri në 14 vjec.

Gjithashtu kemi kujdesur për kriterin gender. Kemi marrë në intervistë vajza dhe djem.

Sigurisht që është patur parasysh edhe kriteri i përfaqësimit të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në çdo Qendër në të cilën janë intervistuar fëmijet për vlerësimin e nevojave.

Më konkretisht si më poshtë vijon:

Zhvillimi i Javës së Aktiviteteve

Për shkak të punës intensive dhe dijeve të sapopërfuara produktet e prodhuara nga fëmijët mbi lojërat e Kompasitos ishin shumë interesante dhe kreative. Ata realizuan punime, vizatime dhe iu prezantuan fëmijëve të tjerë të Qendrave. Kjo ishte edhe risia e këtij projekti, që fëmijët t'ua mësojnë edhe të tjerëve lojërat, qofshin këta moshatarët e tyre apo mësuesit, duke treguar se ata janë të dobishëm. Kjo kontribuon në rritjen e vetëvlerësimit të tyre. Në këtë mënyrë këta fëmijë të ndrojtur iu mësojnë edhe të tjerëve si të angazhohen dhe se si t'i mësojnë më mirë të drejtat përmes aktiviteteve interesante si lojërat.



Përfundime

Projekti krijoi mundësinë e trajnimit për 19 punonjës të Qendrave për Fëmijë në Situatë Rruge. Në të katërt qendrat përfituan trajnim 82 fëmijë.

Personeli i qendrave që u trajnuan u aftësuan që në vazhdimësi të bashkëpunojnë për të identifikuar çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mënyrat më të përshtatshme për të menaxhuar rastet duke konsideruar çdo fenomen të shfaqur nga fëmijët dhe mënyrën e ndërveprimit mes personelit dhe fëmijëve që në shfaqjet më të para të problemeve sociale.

Gjithashtu ky projekt, përmes moduleve të trajnimit dhe broshurave që publikoi mundësoi standartizimin në nivel kombëtar të ndërhyrjeve për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve sociale në këto qendra.

Personeli i qendrave u trajnua për të shërbyer në vazhdimësi si profesionistë përgjegjës për mbikqyrjen e efektivitetit të qasjes mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Qendrat e Fëmijëve në Situata Rruge. Gjithashtu, personeli u aftësua më shumë për trajnimin e anëtarëve më të rinj në këto Qendra, si trajnerë për personelin e brendshëm dhe për stafet e qendrave, apo institucioneve të tjera.

Ndërkohë, fëmijët u aftësuan të krijojnë integritetin e tyre nëpërmjet këtyre metodologjive të reja për pjesëmarrje në vendimmarrje, por edhe për të siguruar vazhdimësinë e ndërhyrjes dhe koherencën e saj.

Manualet e hartuara janë aset për profesionistët e qendrave mbi ndërveprimin, angazhimin në vendimmarrje, aktivizmin, dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ky projekt do të shërbejë si një standart pilot për rritjen cilësore të shërbimeve sociale në ndihmë dhe respektim të të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe angazhimin e tyre në vendimmarrjen e aktiviteteve për fëmijët në realitetin shqiptar me qëllim përhapjen e metodës Kompasito në qendrat e tjera që kanë në fokus fëmijët dhe adoleshentët.

“Manuali për Stafet e Qendrave për Fëmijët në Situata Rruge”- bazuar në metodën Kompasito rezultoi i suksesshëm. Ai shërbeu si një model i ri i ndërveprimit dhe aftësimit të fëmijëve për vendimmarrje.

Qendrat e kanë përfshirë metodologjinë Kompasito në planin mujor të punës duke e aplikuar nëpërmjet lojrave në Qendra krahas aktiviteteve të tjera.